

Këshilli Bashkiak

Këshilli bashkiak përbëhet nga këshilltarë të zgjedhur, sipas dispozitave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Numri i anëtarëve të këshillit bashkiak përcaktohet sipas numrit të popullsisë si më poshtë: - Bashkitë deri në 20 000 banorë 15 anëtarë; - Bashkitë nga 20 001 deri në 50 000 banorë 21 anëtarë; - Bashkitë nga 50 001 deri në 100 000 banorë 31 anëtarë; - Bashkitë nga 100 001 deri në 200 000 banorë 41 anëtarë; - Bashkitë nga 200 001 deri në 400 000 banorë 51 anëtarë; - Bashkitë mbi 400 000 banorë 61 anëtarë.

Funksioni i këshilltarit është i papajtueshëm me:

- a) funksionin e kryetarit dhe zëvendëskryetarit të bashkisë;
- b) funksionin e sekretarit të këshillit bashkiak;
- c) funksionin e nëpunësit të administratës së bashkisë përkatëse dhe institucioneve në varësi të saj;
- ç) funksionin e deputetit;
- d) funksionin e ministrit.

2. Një person nuk mund të zgjidhet në të njëjtën kohë në më shumë se një këshill bashkiak.

3. Nuk mund të jenë anëtarë të të njëjtit këshill personat e lidhur: bashkëshortë, prindër e fëmijë, vëlla e motër, si dhe vjehri e vjehra me nusen e dhëndrin.

Mbledhja e parë e këshillit bashkiak

Këshilli bashkiak zhvillon mbledhjen e tij të parë jo më vonë se 20 ditë nga data e shpalljes së rezultatit nga organi kompetent, i përcaktuar në Kodin Zgjedhor. Mbledhja e parë e këshillit thirret nga sekretari i këshillit bashkiak. Në mungesë të tij, nismën për thirrjen e mbledhjes së parë e merr prefekti.

Në rast se asnjë nga subjektet e sipër-përmendura nuk e ushtron këtë të drejtë, brenda afatit të parashikuar, atëherë këshilli mblidhet vetë brenda 10 ditëve.

Mbledhja e parë e këshillit është e vlefshme kur në të marrin pjesë më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të tij, të shpallur nga organi kompetent, i përcaktuar në Kodin Zgjedhor. Nëse nuk mblidhen më shumë se gjysma e të gjithë anëtarëve të këshillit, mbledhja nuk zhvillohet dhe ajo thirret çdo tri ditë, por jo më shumë se tri herë. Në rastet kur edhe pas tri herë thirrjeje nuk sigurohet pjesëmarrja e kërkuar, këshilli konsiderohet i shpërndarë.

Mbledhja e parë e këshillit, deri në zgjedhjen e kryetarit të tij, drejtohet nga këshilltari më i vjetër në moshë.

Në mbledhjen e parë të këshillit bashkiak:

- a) zgjidhet komisioni i mandateve;

- b) miratohen mandatet e anëtarëve të këshillit;
- c) këshilltarët bëjnë betimin;
- ç) zgjidhen kryetari dhe zëvendëskryetarët e këshillit;
- d) zgjidhen anëtarët që do të përfaqësojnë këshillin bashkiak në këshillin e qarkut dhe pajisen me mandatin e përfaqësimit.

Këshilli konstituohet pas vërtetimit të mandateve të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij.

Mandati i këshilltarit

Mandati i jepet këshilltarit me vendim të këshillit bashkiak. Dhënia dhe heqja e mandatit bëhen me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit. Këshilltari nuk voton për mandatin e tij.

Mandati i këshilltarit mbaron përpara afatit kur:

- a) ndryshon vendbanimin jashtë territorit të bashkisë ku është zgjedhur;
- b) jep dorëheqjen;
- c) krijohen kushte të papajtueshmërisë, të përcaktuara në nenin 47 të këtij ligji;
- ç) mandati, nga ana e tij, është marrë në mënyrë të kundërligjshme;
- d) humbet zotësinë për të vepruar me vendim gjykate;
- dh) vdes;
- e) nuk merr pjesë në mbledhjet e këshillit për një periudhë 6-mujore;
- ë) dënohet për kryerjen e një vepre penale me vendim gjykate të formës së prerë;
- f) këshilli shpërndahet nga organi kompetent.

Mbarimi i mandatit para kohe deklarohet me vendim të këshillit bashkiak, me propozim të komisionit të mandateve

Betimi

Pas verifikimit të mandateve nga komisioni përkatës, këshilltarët bëjnë këtë betim para këshillit: “Beto hem në nderin tim se do të kryej me ndërgjegje detyrën e anëtarit të këshillit bashkiak dhe do t’i bindem Kushtetutës dhe ligjeve. Beto hem se në të gjithë veprimtarinë time do të udhëhiqem nga interesat e shtetasve të bashkisë dhe do të punoj me ndershmeri e përkushtim për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies së tyre”.

Këshilltari që mungon me arsye në bërjen e betimit betohet në mbledhjen më të parë që merr pjesë. Këshilltari, që nuk pranon të bëjë dhe të nënshkruajë betimin, konsiderohet se jep dorëheqjen dhe atij nuk i jepet mandati.